



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 36.

Prishtinë, më 30.01.2019 në ora 15:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

Mungoj: Fikrim Damka, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti dhe Adem Hoxha.

Nga Staffi Mbështetës i Komisionit:, Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Në mbledhje mori pjesë, Nait Hasani - Kryetar i Komisionit për Administratë publike.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu Kodra , Kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura , me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
5. **Të ndryshme.**

Kryetarja tha, sot i kemi në shqyrtim projektligjet që ndërlidhen me administratën publike dhe që duhet te procedohen për shqyrtim në seancë plenare. Falënderoj kryetarin e Komisionit për administratë publike Nait Hasanin për pjesëmarrje në mbledhje ,i cili do të na sqaroj për disa vërejtje të cilat i kemi marrë në moment të fundit për këto projektligje.

1. Miratimi i Rendit të Ditës

Rendi i ditës u miratua i pa ndryshuar.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja tha se është një prej Projektligjeve më të rëndësishme që e kemi diskutua disa herë si Komision , shtetet anëtare e rregullojnë sipas kompetencave të brendshme këtë çështje .

Ne i kemi marr disa vërejtje nga Zyra e Komisionit Evropian për dy projektligjet, për Projektligjin për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe Projektligjin për Zyrtarët publik .Vërejtjet na kanë ardhë me vonesë dhe janë në gjuhën angleze., Është vështirë të gjendet bazë ligjore për një përfrim të qartë me legjislacionin e BE-së sidoqoftë neni 120 i marrëveshjes së stabilizim asoocimit që i jep theks te veçantë administratës shtetërore , pastaj e kemi agjendën e reformave evropiane,ne do ti shqyrtojmë ne komision dhe do ta marrim vendimin.

Andaj hapi diskutimin .

Fatmire Kollçaku tha se pasi vërejtjet e Zyrës së BE-së kanë ardh me vonesë dhe të pa përkthyer, propozoj që të shtyhet ky takim së paku deri nesër në mënyrë që ti analizojmë amendamentet dhe vërejtjet e zyrës së BE-së dhe te dalim me qëndrimin tonë për këto Projektligje.

Ismajl Kurteshi po ashtu propozoj të shtyhet takimi për nesër dhe tha mos te votojmë diçka çka nuk e kemi analizuar dhe nuk jemi te sigurt se çka po votojmë ,

Armend Zemaj pajtohet me parafolësit që sot mos të votohet për këto projektligje dhe pasi qe seanca mbahet te shtunën ta koordinojmë kohen, sepse nëse sot votohet pa i diskutua këto vërejtje, unë do te abstenoj.

Nait Hasani - Kryetar i komisionit për administratë publike tha se kishte qenë më herët edhe ne Komisionin për Legjislacion dhe vërejtjet e Zyrës së BE-së ishin te Kodi penal, kërkohet 3 muaj ose 6 muaj te harmonizohet me kodin penal dhe nuk janë vërejtje serioze që kanë implikime, por është një çështje shumë e thjeshtë, ne i kemi votuar amendamentet janë te harmonizuara mirë në të 3 projektligjet dhe nuk kanë kolizion njëra me tjetrën

Kurse sa i përket Komisionit për integritet Evropiane ju i jepni vërejtjet se a ka shkelje te Acquis communautaire apo jo.

Visar Ymeri pajtohet me parafolësin lidhur me përputhshmërinë e ligjeve me Acquis communautaire, por tha se duhet pas parasysh se ka një frymë Evropiane apo standarde që e kanë përmend nga njëra nga amendamentet që i pashë, që janë praktikat më të mira ndërkombëtare. Po ashtu tha se është dakord që na duhet kohë me i analizua këto amendamente dhe propozimet që i ka sjell Zyra e BE-së .

Kryetarja pas diskutimeve konstatoj që pasi vërejtjet e Zyrës së BE-së kanë ardhë me vonesë dhe të pa përkthyer në Komision dhe nuk kishin pas kohë ti analizojnë , kërkoj nga anëtarët që të deklarohen se a pajtohen që mbledhja të shtyhet për ditën e nesërme në ne orën 10:00 dhe të shqyrtohen këto 3 projektligje se bashku me vërejtjet e Zyrës së BE-së.

Pas votimit Kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri u pajtua që të nesërmen ne orën 10, të mbahet mbledhja e Komisionit dhe të shqyrtohen këto 3 projektligje.

Mbledhja përfundoi ne orën 16:15.

**Përgatitur nga
Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetare e Komisionit
Blerta Deliu-Kodra**
